



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 1924/2 prot.

Tiranë më 30.8.2024

Lënda: Mbi dorëzimin e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027
(Faza Teknike)

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, ka përgatitur përmes formateve standarde tabelarë kërkesat buxhetore, në përputhje me Ligjin nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, së bashku me kërkesat shtesë për fonde buxhetore, përtej tavaneve përfundimtare.

Bashkëlidhur kërkesave buxhetore gjeni relacionin shpjegues.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Konceptoi: L. Morina



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

RELACION

MBI

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027

FAZA TEKNIKE

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 27.03.2024, "*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*", Udhëzimit nr.9, datë 28.02.2019 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor*", Udhëzimit Plotësues nr.4, datë 28.02.2024 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*", Grupi i Menaxhimit Strategjik në Institucionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, (në vijim "*Zyra e Komisionerit*" ose "*KDIMDP*") ka përgatitur dhe finalizuar kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm (projekt buxhetin) për vitet 2025-2027, Faza Strategjike, ku ka paraqitur edhe kërkesat shtesë, sipas prioritetëve.

Në zbatim të VKM nr.535, datë 12.08.2024 "*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 10.07.2024 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*", GMS në Institucionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka përpunuar detajet teknike të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Faza teknike (Faza e dytë), shoqëruar me anekset përkatëse, por ndërkohë edhe kërkesat shtesë, edhe pse Udhëzimi nuk e parashikon një gjë të tillë.

Vizioni ynë është inkurajimi për marrjen e masave proaktive, zbatimin e parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale në integrimin e teknologjisë, si dhe rritjen e llogaridhënies për pjesëmarrje të qytetarëve në qeverisje.

Misioni ynë mbetet dhënia e garancisë mbi aksesin dhe njohjen e qytetarëve me informacionin publik si dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e në veçanti të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo materializohet nëpërmjet qëllimit të programit i cili është:

1-Nxitja e përputhshmërisë së sektorit publik dhe privat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

2-Vendosja e balancës midis dy të drejtave të shtetasve, duke ofruar ekspertizën për ligjbërësit kombëtarë, me qëllim adoptimin e standardeve evropiane në të dyja fushat.

3-Realizimin e mbikëqyrjeve/inspektimeve për zbatimin e detyrimeve ligjore, vendosjen e sanksioneve administrative në rastet flagrante të shkeljes së detyrimeve, shqyrtimin e ankesave në lidhje me të drejtën për akses në informacionin publik apo cënimin e privatësisë, në bazë të të cilave Komisioneri ushtron vendimmarrjen e tij.

4-Menaxhimin me efektivitet dhe korrektësi i fondeve buxhetore të KDIMDP-së.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2024 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ndryshimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit”;
- miratimi i akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit të ri;
- përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në funksion të përparimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si detyrime specifike që burojnë nga legjislacioni i përmirësuar;
- bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit në njohjen e risive rregullatore në të dy fushat, në ndërgjegjësimin për zbatimin e tyre;
- komunikimi proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së transparencës, forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim dhe trajnimi periodik i koordinatorëve për të drejtën e informimit veçanërisht për trajtimin e çështjeve me interes publik në balancë me kufizimet për dhënien e informacionit;
- thellimi i mbikëqyrjes dhe monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, të ndryshuar, duke patur si qëllim rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike si dhe garantimin e aksesit në informacion publik;
- verifikimi dhe mbikëqyrja e transparencës proaktive të autoriteteve publike, mbi zbatimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- komunikimi proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së nxitjes së qasjes së re të kontrolluesve/përpunuesve përsa i përket garantimit efektiv të sigurtisë së informacionit (SMSI) në proceset përpunuese;
- përgjegjshmëria e lartë e kontrolluesve publik për t’iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve mbi projektaktet ligjore/nënligjore, që në objekt të tyre kanë përpunimin e të dhënave personale;
- zgjerimi i rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimi i kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- organizimi i edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në datat 3-5 qershor 2024 në Tiranë, e cila synon të promovojë fuqizimin e rolit të individit përmes aksesit në informacion në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur;

- roli aktiv në kuadër të organizmave ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është anëtare, si dhe me autoritetet homologe në të dy fushat e përgjegjësisë;
- aplikimin për përfitimin e projekteve nga programe të asistencës nga fondet IPA të BE dhe/ose donatorë të tjerë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe për ndërgjegjësimin e grupeve të interesit.

Zyra e Komisionerit, në realizimin e misionit të saj është udhëhequr dhe do të vijojë të udhëhiqet nga parimi i forcimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe etike të stafit. Qasja e institucionit është për edukim të vazhdueshëm, duke përqafuar metodat më bashkëkohore dhe inovative në funksion të ushtrimit efikas të veprimtarisë së tij.

Si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, do të forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme. Kjo Zyrë ushtron edhe funksione të tjera në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, monitorimit të sektorëve me sensibilitet të veçantë apo që kanë të bëjnë me aspektet e integritetit dhe mirëqeverisjes, në bazë të kompetencave që i janë dhënë me ligje apo strategji të veçanta, të cilat do të detajohen në brendësi të këtij relacioni.

Hartimi i këtij Projekt-Buxheti (2025-2027), bazohet në analizën e performancës institucionale për vitin 2023 të Zyrës së Komisionerit, pritshmërive për vitin 2024, detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar, nivelit të plotësimit të indikatorëve, që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë në nivel kombëtar dhe detyrime të tjera për zbatim, të cilat burojnë nga legjislacione vendase por edhe nga detyrimet e legjislacionit të përafuar me *aquiss communautaire*, ku forcimi i rolit mbikëqyrës për zbatimin e tyre, nuk mund të realizohet pa forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare.

Buxheti real për të cilin ka nevojë Zyra e Komisionerit, janë paraqitur në Fazën Strategjike (politikat ekzistuese dhe të reja), por për arsye të detyrimeve ligjore, pasqyrat në këtë fazë teknike janë plotësuar sipas formateve të Udhëzimeve të MFE për përgatitjen e PBA-së dhe nivelit brenda tavaneve përfundimtare (*Shtojca I-A – pasqyrat shitesë për buxhetin 2025-2027*). Por vlen të theksojmë faktin se tavanet përfundimtare (miratuar me VKM nr. 535, datë 12.08.2024 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm (2025-2027), janë të pakonsultuara paraprakisht, duke konstatuar mospërbushje të nevojave dhe prioriteteve të Zyrës së Komisionerit, edhe pse të argumentuara drejt. Ndaj vijojmë të paraqesim kërkesat shitesë përtej tavaneve, duke evidentuar gjerësisht zbatimin e detyrimeve që burojnë gjatë procesit të integritetit apo zhvillimeve të fundit të teknologjike dhe sigurisë, brenda vitit 2025.

Më gjerësisht arsyetimi sipas detyrimeve:

Zyra e Komisionerit si pjesë e institucioneve të pavarura shqiptare, ka qenë kontribuese aktive në të gjitha fazat e procesit të integritetit dhe përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE, për hapjen e negociatave për anëtarësim e vendit në Bashkimin Evropian (BE). Në këtë kuadër, është dhe do të vijojë të kryehet një punë intensive dhe cilësore sipas kapitujve.

- Angazhimi konkret i institucionit si kontribues në **Kapitullin 10 “Transformimi digjital dhe media”**. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është organi përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve sipas Ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” i cili është përafruar pjesërisht me Direktivën (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”.

- Angazhimi konkret i institucionit si kontribues në **Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”** në shërbim të procesit të integritetit ku bazuar në VKM nr. 736/2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, Zyra e Komisioneri ka përgjegjësi për zbatimin dhe përmbushjen e rekomandimeve dhe masave të përfshira në këtë Udhërrëfyes.

- Angazhimi konkret i institucionit si kontribues në **Kapitullin Kriteri Politik “Reforma në Administratën Publike”**.

-Angazhimi konkret i institucionit si kontribues **Kapitullit “Funksionimi i Institucioneve Demokratike”**.

Referuar detyrave dhe përgjegjësiave për secilin kapitull, si dhe duke analizuar kapacitetet ekzistuese, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar të nevojshëm një shtesë mbi strukturën e miratuar të institucionit, me një numër **prej 10 punonjësish** në vitin 2025 dhe në proporcion me përmbushjen e funksioneve me shtimin gradual të tyre në dy vitet më tej, 12 punonjes në vitin 2026 dhe po aq në 2027, kryesisht në drejtoritë e përmbajtjes, rregullatore por dhe në ato të mbështetjes.

Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë është depozituar analiza dhe vlerësimi për shtesë në kapacitete njerëzore të institucionit tonë, të përfshirë në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitujt ku Zyra e Komisionerit ka angazhimet e saj me përgjegjësi dhe detyrat konkrete të përcaktuara e të ndërlidhura me procesin e integritetit, referuar më sipër. Kjo analizë është dërguar për dijeni edhe pranë Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, të cilët do të vlerësojnë kërkesat dhe konfirmojnë numrin e nevojshëm të stafit për Zyrën e Komisionerit, në përmbushje të këtij misioni tepër të rëndësishëm për Shqipërinë.

Zyra e Komisionerit në fazën strategjike të hartimit të PBA 2026-2028, do të kryejë një analizë më të detajuar në lidhje me nevojat për burime njerëzore shtesë dhe forcim kapacitetesh për të ushtuar funksionet dhe detyrat e saj, në përmbushje edhe të rekomandimit të lëna në “Udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës - Kuadri i përgjithshëm të të drejtave themelore” sipas të cilit: “Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duhet të kryejnë një analizë për nevojat e forcimit të kapaciteteve brenda vitit 2024, me qëllim që të sigurojnë burime të përshtatshme bazuar në objektivat vjetore nga viti 2026 e në vazhdim”.

Në Fazën Strategjike është paraqitur ky informacion paraprakisht, për tu njohur dhe marrë në konsideratë nga ana juaj, pas ndryshimeve **të mundshme strukturore** duke filluar nga viti 2025. Gjatë prezantimit të PBA 2025-2027, në fazën strategjike por edhe në këtë fazë,

nuk janë përfshirë kostot administrative si kërkesa shitesë, pasi ende nuk ka miratim ligjërish të ndryshimeve strukturore, të cilat do të prezantohen dhe reflektohen pas miratimit nga strukturat përgjegjëse të shtesës së numrit të punonjësve.

Tabela referuese për shtesa 10 -12-12 punonjës për vitet 2025-2027:

Në mijë lekë

EMËRTIMI	KËRKESAT SHITESË POLITIKAT EKZISTUESE			
	VITI 2025	VITI 2026	VITI 2027	TOTALI për tre vite
Shp. Paga e Sig. Shoq.	21.000	25.000	25.000	71.000
Shp operative	3.000	5. 000	5.000	13.000
Shp.kapitale të brendshme	4.000	3. 000	3.000	10.000
Totali	28.000	33.000	33.000	94.000

Gjithashtu në prezantimin e PBA 2025-2027, janë paraqitur **efektet financiare shitesë** për zbatimin e Ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, për tre vitet e PBA 2025-2027 sipas shkresës së AKCESK, me nr. Prot 370, datë 23.04.2024, e në vijim me shkresën nr. 121/18, datë 30.07.2024 të AKSK, për vitin 2025. Gjithashtu së fundmi, AKSK, ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit raportin e vlerësimit të qëndrueshmërisë kibernetike, të detajuar sipas gjetjeve, me nr. 508/2 prot, datë 23.08.2024. AKSK sjell në vëmendje në këtë raportim rëndësinë e implementimit të masave korrigjuese sipas rekomandimeve të dhëna, brenda afateve (2025), me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në rrjetet dhe sistemet e instaluar. Përlllogaritja e efekteve financiare për institucionin tonë është realizuar nga kjo e fundit, mbi bazën e numrit të rrjeteve dhe sistemeve të disponueshme, duke marrë në konsideratë koston për infrastrukturën e sigurisë kibernetike, implementimin e standarteve dhe rritjen e kapaciteteve. Për të mundësuar zbatueshmërinë e këtij ligji, ligjvënasi ka vlerësuar dhe miratuar tabelat respektive me kostot financiare të ndara, sipas institucioneve dhe viteve të PBA (2025-2027), ku edhe Zyra e Komisionerit është pjesë.

AKSK ka vijuar gjithashtu me procesin e vlerësimit të sigurisë kibernetike, duke dërguar pranë institucionit të KDIMDP-së me shkresën nr. 392/4, datë 27.08.2024- Raportin final të vlerësimit të dobësive të Sigurisë Kibernetike në infrastrukturën TIK të Zyrës së Komisionerit. Në konkluzionet përfundimtare, me qëllim mirëqeverisjen e sigurisë së Informacionit në KDIMDP, si dhe minimizimin e riskut dhe afektimin nga incidentet e mundshme kibernetike, kanë rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim.

Përsa konstatuar dhe rekomanduar, duke marrë në konsideratë situatën aktuale kibernetike, sulmet e vazhdueshme drejt infratrakturave publike si dhe risqet e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit, kostot e vlerësuara për sigurinë kibernetike nga AKSK, për institucionin tonë, janë rivlerësuar edhe nga ekspertët e IT brenda institucionit, për të cilën i qëndrojmë koherent, kërkesës për fonde shitesë për vitin 2025,

në përmbushje të rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, duke garantuar në nivele të larta sigurinë e informacionit e më gjerë, brenda Zyrës së Komisionerit. Do të vijohet me rishikimin e vlerësimit të kostove financiare për vitet 2026-2027, sipas analizave të gjendjes aktuale të infrastukturës, koordinuar edhe me ekspertët e AKSK.

Përsa eidentojmë në miratimin e tavanëve përfundimtare, nuk janë marrë në konsideratë impaktet/efektet financiare të llogaritur nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për tre vitet e për më tepër për vitin e parë 2025, sipas shkresës 121/18 datë 30.07.2024, për nevojat e menjëhershme, lidhur me mbrojtjen kibernetike sipas komponentëve konkrete. Ju si institucioni përgjegjës për financat publike, jeni njohur, dakordësuar dhe orientuar njësitë e qeverisjes qendrore, për paraqitjen në fazën teknike të PBA-së 2025-2027, të **kërkesave shitesë për vitin 2025** sipas efekteve të përlllogaritura nga AKSK, për çdo komponent.

Infrastruktura: Në infrastrukturë do të vijohet me sigurimin e pajisjeve dhe plotësimin e mangësive për garantimin në nivelet më të larta të sigurisë kibernetike, si Blerja e pajisjeve të kërkuara, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës aktuale të pajisjeve TIK, garantimin e sigurisë së infrastrukturës *network* në institucion, duke integruar modulet e menaxhimit si: *Active Directory* dhe *Domain Controller* për menaxhimin e user-ave, pajisjeve dhe aplikacioneve (hardware e softwerw) si dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet teknologjike apo dhe më gjerë (licensa, sisteme etj)

Standardet: Referuar strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të AKSK, si dhe raportit përfundimtar për sigurime TIK në Zyrën e KDIMDP-së, në diskutimet edhe me AKSK, ky komponent, vlerësuar financiarisht, lidhet me ngritjen dhe implementimin e standarteve si dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore të specializuar në fushën kibernetike apo ndryshime të teknologjive. Sipas rekomandimit të AKSK duhet të vijohet jo vetëm me shtimin e burimeve njerëzore të posaçme për sigurinë kibernetike, por edhe me krijimin e standarteve të certifikuara për monitorim, sipas modeleve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Trajnimet: Në lidhje me këtë komponent, duhet të vlerësojmë që teknologjia e informacionit ndryshon e zhvillohet më shumë, për pasojë kërkon rritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe certifikimeve të vazhdueshme, për stafin dhe punonjësit me profil IT, për përmirësimin e njohurive teknike.

Në lidhje me efektet financiare të ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, vlerësuar, rekomanduar nga AKSK dhe në përmbushje të nevojave institucionale kërkesat janë si e sa më poshtë:

Tabela e mëposhtme/ shitesë referuese:

VITI 2025

Nr	Emri i Institucionit	%	Infrastruktura investime	Standartet Shpenzime	Trajnimet shpenzime	Totali
1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP)	4	5,612	7,355	11,033	24,000

VITI 2026

Nr	Emri i Institucionit	%	Infrastruktura investime	Standartet Shpenzime	Trajnimet shpenzime	Totali
1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP)	4	42, 930	4,293	11,033	58,256

VITI 2027

Nr	Emri i Institucionit	%	Infrastruktura investime	Standartet Shpenzime	Trajnimet shpenzime	Totali
1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP)	4	28,220	2,822	8,825	39,867

Mbetet për tu vlerësuar gjatë hartimit dhe miratimit të Ligjit të Buxhetit 2025, përfshirja e komponentëve (**investime në teknologji, procese/standarte dhe burime njerëzore të trajnuara**).

Konstatimet e mangësive të financimit

VKM nr. 184, datë 27.03.2024, "*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*", por as VKM nr.535, datë 12.08.2024 "*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027*", nuk ka reflektuar financimin e plotë në paga e sigurime shoqërore për numrin e miratuar të punonjësve me ligjin e Buxhetit nr. 97/2023 "*Për buxhetin e vitit 2024*", referuar Vendimit të Kuvendit nr.24/2023 "*Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018*" "*Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", e cila

prej vitit 2024 është bërë efektive. Por për më tej, as reflektimin e VKM-ve të reja 2024 (VKM nr. 421, datë 26.06.2024 si dhe nr. 422, datë 26.06.2024) në sistemin e pagave për punonjësit e nivelit egzekutiv dhe atyre mbështetës.

Edhe pse të argumentuara drejt, vlerësuar edhe nga MF gjatë analizës buxhetore të fazës së parë (Strategjike) mbi PBA 2025-2027, kërkesat shtesë për mbështetje financiare, kryesisht në shpenzimet paga dhe ato për investime, janë të pakonsultuara me Zyrën e Komisionerit dhe për pasojë miratimi i tavanëve nuk përmbush nevojat institucionale. Ritheksojmë se mungesa e alokimit të kërkesave shtesë (shtuar edhe të rejat), do të kufizojë veprimtarinë institucionale, duke ndikuar negativisht në të gjithë aspektin funksional dhe ekzistencial.

Kërkesat buxhetore të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsultohen me elementë të shoqërisë civile, gjatë raportimeve për plotësimin e masave dhe indikatorëve të parashikuara në strategjitë konkrete.

Zyra e Komisionerit është institucion i përfshirë në disa strategji kryesore ndërsektoriale në vend, nëpërmjet objektivave që lidhen me fushën e veprimtarisë e për të cilat është përgjegjëse/mbështetëse në zbatimin e tyre. Ministria e financave ka marrë në konsideratë argumentimin e Zyrës së Komisionerit, duke miratuar fondin e shtuar në shpenzimet operative, i cili nuk duhet të jetë shterues për vitet më tej.

Listimi i strategjive aktuale por edhe të pritshme, ku parashikohet të shoqërohet në hartimin e PBA 2026-2028 **me kërkesa shtesë:**

♣ **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030**, ku institucioni kontribuoi gjatë veprimtarisë së tij për realizimin e sfidës “Mbrojtja e të dhënave të qytetarëve sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave dhe forcimi/promovimi i transparencës proaktive me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteve publike”, në kapitullin “Forcimi i të drejtave të njeriut”.

Në kuadër të procesit *screening*, Zyra e Komisionerit, ka parashikuar aktivitete konkrete për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në dokumentet politike dhe strategjike me qëllim adresimin e gjetjeve të Raportit të Shqyrtimit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës - Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” (miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023) dhe Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike (miratuar me VKM nr. 737, datë 13.12.2023).

♣ Zyra e Komisionerit është pjesë e **Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2024-2030**, ku është përgjegjëse për zbatimin e objektivit D3: “Institucionet e administratës publike janë transparente dhe ofrojnë të gjithë informacionin e kërkuar nga publiku bazuar në ligjin për të drejtën e informimit dhe zbatojnë legjislacionin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, nëpërmjet zbatimit të këtyre masave.

♣ **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026**, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Indikatorëve, ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij masën:

1.1.10: “Fushata ndërgjegjësuere kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin”, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve.

1.1.10.1: “Fushatë kombëtare ndërgjegjësuere me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktime, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative)”.

♣ **Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023** dhe Plan i Veprimit 2019–2023, ku institucioni është përgjegjës dhe kontribuoi gjatë veprimtarisë së tij për përmbushjen e objektivit specifik 4.1: “Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike”.

♣ Zyra e Komisionerit është pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2024-2030, e cila ka si qëllim adresimin e sfidave në avancimin e luftës kundër korrupsionit për një shoqëri në të cilën vlerat kryesore, si integriteti, transparenca dhe përgjegjësia udhëheqin veprimet dhe sjelljen e qytetarëve të saj. Si institucioni i cili garanton zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit, si një nga të drejtat themelore të njeriut, që vepron si parakusht për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse, Zyra e Komisionerit ka një peshë kryesore në zbatimin e masave të parashikura në këtë strategji.

Masat e parashikuara janë: “*Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit*” dhe “*Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes*”, të cilat do të përmbushën nëpërmjet një serë aktiviteteve.

♣ **Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijëve 2021–2026**, ku institucioni është përgjegjës dhe përmbushi gjatë veprimtarisë së tij objektivin specifik IV.1: “Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale”.

♣ **Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030 dhe planit të saj të veprimit 2024 – 2026**, ku Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteteve si më poshtë:

- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe rishikimi i strukturave në institucionet në nivel qendror dhe vendor për qeverisjen efektive të migracionit: “Fushatë ndërgjegjësuere me punonjës policie, psikolog, inspektorë të punës, punonjës të policisë të kufirit dhe stafit të autoriteteve kombëtare që mbulojnë çështjet e azilit dhe migracionit me fokus zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.
- Hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara:
 - ✓ *Krijimi i një metodologjie të koordinuar për mbledhjen e të dhënave (sipas planit të statistikave).*
 - ✓ *Zhvillimi i trajnimeve për realizimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit, shkëmbimit dhe ndërveprimit të të dhënave personale, me qëllim rritjen e aftësive të nëpunësve të ngarkuar me mbledhjen e të dhënave të migracionit.*

♣ **Strategjinë Antikorrupsion (SNKK) 2023-2030** ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 *“Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion”*

♣ Zyra e Komisionerit është kërkuar të jetë pjesë edhe e **Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 – 2030**, ku parashikohet të jetë kontribuese për realizimin e objektivit “Forcimi i bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e Edukimit Ligjor të Publiku dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë”, nëpërmjet masës dhe aktiviteteve si më poshtë:

- *Masa: “Fushata ndërgjegjësuere dhe edukuese për publikun mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.*
- *Aktivitetet:*
 - *Zhvillimi i aktiviteteve informuese me grupe të ndryshme interesi, posaçërisht në institucione arsimore parauniversitare;*
 - *Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) në kuadër të detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen me Eurojust;*
 - *Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me organet ligjzbatuese me qëllim prezantimin e tyre me risitë që sjell Direktiva e Policisë, si pjesë integrale e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen me Eurojust;*
 - *Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të përpunimit të të dhënave të pasagjerëve PNR/API;*
 - *Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për qytetarët/administratën publike me qëllim përmbushjen e të drejtës për t’u njohur me informacion publik, nëpërmjet zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit;*
 - *Organizimi i takimeve/leksioneve të hapura me studentët e Fakultetit të Drejtësisë për t’u njohur me rolin dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit.*

Për shkak të angazhimeve të shumta që Zyra e Komisionerit ka si rezultat i rekomandimeve të lëna nga Raporti i Shqyrtimit të Komisionit Evropian për periudhën 2024- 2030 për të dy fushat e përgjegjesisë, gjithashtu dhe kontributit që kërkohet nga ana e Zyrës së Komisionerit në strategjitë e sipërcituara ndërsektoriale, institucioni do të propozojë krijimin e një strukture të posaçme brenda tij për koordinimin e proceseve të sipërpërmendura. Këto kërkesa janë reflektuar edhe në vlerësimin e kapaciteteve institucionale brenda Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) në kuadër të *“Kornizës së përbashkët metodologjike e vlerësimit të kapaciteteve & strukturave të integritetit evropian (CAF)”*, dërguar Ministrit të Shtetit dhe Kryengjiciator më shkresën nr. 1116/1 Prot, datë 29.04.2024.

Për paraqitjen e dokumentit të PBA 2025-2027, Zyra e Komisionerit vijon të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen dhe plotësimin e PBA-së në sistemin AFMIS, deri në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Zyra e Komisionerit. Në funksion të

zbatimit të rekomandimit të Zyrës së Komisionerit lidhur me këtë sistem, do të shihet edhe mundësia e paraqitjes së PBA 2026-2028 me formatet e gjeneruara nga sistemi AFMIS. Gjithsesi është ruajtur i njëjti format zyrtar i paraqitjes, duke mos u bërë pengesë për vlerësim të kërkesave buxhetore dhe bërjes efektive të tyre.

Zyra e Komisionerit vijon të konsultohen me nivelet e buxhetimit të disa institucioneve të tjera të pavaruara, ku natyra e punës është e njëjtë ose e përafërt. Nga analiza e dokumentit të PBA-së, konstatohet se nivelet e shpërndarjes së buxheteve nuk janë në proporcion me veprimtarinë, funksionet e tyre dhe kërkesat e tyre. Ndaj do të sugjerohet të kryhej një analizë e mirëfilltë e kërkesave buxhetore për secilin institucion, duke alokuar fonde në mënyrë të drejtë dhe efektive, **kryesisht apo kapitale**.

Përsa më sipër dhe në zbatim të udhëzimeve për hartimin dhe finalizimin e dokumentit të PBA 2025-2027, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) vendosi të paraqesë në këtë relacion dhe plotësojë vetëm formatet standarte të udhëzimit të PBA nr. 9, datë 10.07.2024, por ndërkohë edhe pse në pikën 3 të këtij Udhëzimi përcaktohet se:

Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të risjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese. Kërkesat shtesë, të paraqitura duhet të vlerësohen dhe mbahen në konsideratë nga ana juaj gjatë miratimit të fazës së fundit të Buxhetit, të nogociuara dhe prezantuara edhe në takimet e muajit shtator, sipas kalendarit të publikuar.

NË LIDHJE ME KËRKESAT SHITESË PËRTEJ TAVANEVE (POLITIKA EKZISTUESE)

Me Vendimin nr. 24/2023 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, struktura prej 60 punonjësisht , i ka shtrirë efektet e saj menjëherë. Struktura është e pashoqëruar me efektet financiare të plota edhe pse ka reflektime minimale në shpenzimet e personelit, miratuar në tavanet përfundimtare e PBA 2025-2027, një shtese prej 4.000 (në mijë) lekë

Kërkohet shtesë fondesh në Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore”, me rreth 15 % të tavanëve indikative, në shumën **14.600 (në mijë) lekë**, i përlllogaritur për vitet 2025-2027, detajuar në tabelën 1 për politikat egzistuese

2-Artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, e cila parashikohet të jetë me një shtesë prej 2.000 (në mijë) lekë për vitin 2025, mbi tavanet e miratuara, detajuar në tabelën 1 për politikat egzistuese, detajuar për çdo vit.

- **“Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”, parashikohen të jenë në shumën 2.000 (në mijë) lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese si një shtesë e tavanëve indikative, i përlllogaritur për vitet 2025-2027**

1-Artikulli 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupëzuara”, parashikohet të jetë në shumën **27.000 (në mijë) lekë, për vitin 2025,** ndërsa do të mirëmbahet infrastruktura çdo vit me fondet e shpenzimeve operative, e për çdo vit sipas tabelave respektive

- **“Shpenzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme/Blerje Automjeti”,** parashikohet të jetë në shumën **6.000 (në mijë) lekë, sipas testimit të tregut për një mjet 4+1 vende me specifika normale**

Nevoja për shtimin e 1 (një) mjeti të ri transporti është domosdoshmëri. Aktualisht institucioni ka në përdorim 2 automjete, të cilët i përkasin viteve 2007-2009. Nisur nga vitet e përdorimit, amortizimit të tepërt, koston së lartë të mirëmbajtjes, kërkesa për zëvendësimin e tyre (dy mjete) me 1 (një) mjet të ri, do të kishte shumë efektivitet në përdorimin e fondeve publike. Për të dy mjetet më lart, po shihet mundësia e kalimit kapital në autoritete publike që shprehin interes, siç u veprua edhe në vitin 2021 ku u kaluan 2 mjete në pronësi të Zyrës së Komisionerit në institucionet e pushtetit vendor.

Kjo kërkesë është prezantuar edhe gjatë PBA 2024-2026 si dhe në fazën e parë strategjike 2025-2027

Blerja e automjetit të ri, do të ndihmonte në mbarëvajtjen e punës për punonjësit e Zyrës së Komisionerit, për realizimin inspektimeve të shtuara, në të dy fushat e përgjegjësisë, të cilat janë shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Rritja e numrit të aktiviteteve ndërgjegjëse në të gjithë vendin, siguria në lëvizje si dhe mirëadministrimi i fondeve buxhetore, është një tjetër arsye për përdorimin e mjeteve të reja.

- **“Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”,** parashikohen të jenë në shumën **2.000 (në mijë) lekë,** për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve, si një shtesë e tavaneve indikative, i përllogaritur për vitet 2025-2027
- **“Dixhitalizimi i Programit të Transparencës”,** i cili parashikohet të jetë në vlerën **8.000 (në mijë) lekë,** pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma parashikohet të financohet me **fondet e vitit 2025.**

Për shkak të nevojave institucionale në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e informacionit dhe mbikëqyrjes së transparencës të autoriteteve publike dhe në zbatim të ligjit nr. 25/204 “Për Sigurinë Kibernetike” si dhe përllogaritjen e efekteve financiare që lindin nga ky ligj, duhet planifikuar buxheti për të qendëruar infrastrukturën e monitorimit të këtyre autoriteteve në përputhje me standardet më të larta të sigurisë për ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit online.

Qëllimi i kësaj platforme është përmirësimi i procesit të ruajtjes, procesimit, monitorimit dhe raportimit të Programit të Transparencës, duke filluar nga organet e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e transparencës dhe besueshmërisë ndaj publikut.

Programi i transparencës do të plotësohet elektronikisht nga të gjitha institucionet duke krijuar një bazë të dhënash solide dhe duke reduktuar kohë gjatë procesit të monitorimit dhe raportimit.

- **Artikulli 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të gendrueshme të trupëzuara”,** parashikohet të jetë në shumën **11.000 (në mijë) lekë, për vitin 2025,** ndërsa do të mirëmbahet infrastruktura çdo vit me fondet e shpenzimeve operative

Projekti :

- **“Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrat elektronik të thirrjeve të pakërkuara”.**

